



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 16, me Rregulloren Nr.2001/19 të datës 13 shtator 2001, neni 1 paragrafi 1.3, nënparagrafi (c) dhe (d), me qëllim të zbatimit të Ligjit për Produktet Medicinale dhe Pajisje Medicinale, Ligjit për Barna Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekursor nxjerr:

Udhëzim Administrativ (në Shëndetësi) Nr. 01/2010
Recetat në Sistemin Shëndetësor në Republikën e Kosovës

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është unifikimi, standardizimi, përcaktimi i formës, mënyra e plotësimit, personat përgjegjës për plotësimin dhe administrimin e tyre dhe vënia në përdorim e Recetave në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 2
Llojet e Recetave

1. Në Sistemin shëndetësor në Kosovë janë në përdorim tre lloje të recetave:
 - 1.1. Receta për Barna, e cila përdoret në institucionet shëndetësore publike
 - 1.2. Receta për Barna, e cila përdoret në institucionet shëndetësore private
 - 1.3. Receta për Narkotik, e cila përdoret në institucionet shëndetësore publike

Neni 3
Specifikat e Recetave

1. Receta për Barna, e cila përdoret në institucionet shëndetësore publike ka numrin e referencës DM0107
 - 1.1 Kjo recetë ka sfond të bardhë me shkronja ngjyrë të zezë dhe plotësohet vetëm në një fletë, Shtojca.
2. Receta për Barna, e cila përdoret në institucionet shëndetësore private ka numrin e referencës DM0107P, Shtojca
 - 2.1 Kjo recetë ka sfond të verdhë me shkronja ngjyrë të zezë dhe plotësohet vetëm në një fletë;

3. Receta për Narkotik ka numrin e referencës DM0107N
 - 3.1 Receta për Narkotik ka sfond të bardhë me shkronja ngjyrë të kuqe dhe plotësohet në një fletë, origjinali dhe kopja. Fleta e parë ruhet në barnatore së paku 5 vite bazuar në Ligjin Nr. 02/L-128, neni 15, paragrafi 15.4, ndërsa kopja i dorëzohet pacientit. Shtojca.
 - 3.2 Në Recetën për Narkotik në pjesën e pasme të origjinalit dhe kopjes vendoset vula katrore e farmacisë me format 90mmx70mm, me përmbajtje: Emri dhe mbiemri i personit që tërheq barin, numri personal, nënshkrimi dhe data e tërheqjes;
4. Recetat shtypen në gjuhët zyrtare, Shqip dhe Serbisht, me numër serik dhe shënjen e sigurisë.
5. Formati i Recetave është 210mmx145mm.

Neni 4 Përmbajtja e Recetave

- 1 Recetat përbëhen nga tre pjesë:
 - 1.1 Pjesa e përgjithshme përfshin të dhënat për institucionin, mjekun dhe pacientin.
 - 1.2 Pjesa speciale ku përshkruhet diagnoza, terapia, mënyra e përdorimit të barit, radha e dhënjes së barit, nënshkrimi, faksimili dhe numri i telefonit të mjekut.
 - 1.3 Pjesa ekzekutive, përmban kodin nacional, çmimin e barit, numrin e recetës, datën e ekzekutimit të recetës, vendin e barnatores, nënshkrimin dhe faksimilin e Farmacistit.

Neni 5 Plotësimi i Recetës

- 1 Receta për barna-DM0107 plotësohet nga Doktor i Mjekësisë ose Specialisti i Mjekësisë Familjare në institucionet shëndetësore të Kujdesit Parësor Shëndetësor publik: QKMF, QMF dhe ASH;
- 2 Receta për barna-DM0107 plotësohet nga Doktor i Stomatologjisë në institucionet shëndetësore të Kujdesit Parësor Shëndetësor për barnat specifike për trajtim stomatologjik;
- 3 Receta për barna-DM0107P plotësohet nga Doktor i Mjekësisë ose Specialisti i Mjekësisë Familjare në institucionet shëndetësore të licencuara të sektorit privat.
- 4 Vulën katrore në pjesën e pasme të recetës për narkotik-DM0107N, në origjinal dhe kopje e plotëson farmacisti ndërsa nënshkruhet nga personi që tërheq barin.

Neni 6 Përshkrimi i barnave në Recetë

1. Në shërbimet specialistike konsultative të Kujdesit Parësor, Dytësor dhe Tretësor të sektorit publik përshkrimi i barnave bëhet në Raportin nga Konsulta.
2. Shërbimet specialistike konsultative në KPSH, KDSH dhe KTSH të sektorit publik dhe në institucionet shëndetësore të licencuara të sektorit privat të cilat ofrojnë shërbime

specialistike-konsultative, përshkrimin e Narkotikëve e bëjnë në Raportin nga Konsulta.

3. Recetat plotësohen në përputhje me Doracakun mbi mënyren e plotësimit të dokumentëve shëndetësore;
4. Të dhënat në receta duhet të shkruhen me shkrim të lexueshem, qartë me laps me ngjyrë ose laps kimik me ngjyrë të kalter.
5. Në receta mund të përshkruhet bari në sasi e cila i përgjigjet gjendjes shëndetësore dhe natyrës së sëmundjes por më së shumti në sasi të mjaftueshme për mjekim, 90 ditë.
6. Në receta, të të sëmuret me sëmundje kronike, mund të përshkruhet sasi e barit e mjaftueshme për mjekim prej 90 ditësh.
7. Receta DM0107 dhe DM0107P vlen 15 ditë prej ditës së përshkrimit, përveq në rast të përshkrimit të Antibiotikëve kur vlefshmeria e recetës është 3 ditë prej ditës së përshkrimit.
8. Receta DM0107N vlen 5 ditë prej ditës së përshkrimit të narkotikëve dhe substancave psikotrope.

Neni 7

Barnat që përshkruhen në Receta

1. Në DM0170N përshkruhen barnat narkotike dhe substancat psikotrope, shtojca: 4, e këtij udhëzimi, bazuar në Ligjin Nr 02/L-128, nga Tabela II dhe III të cilat posedojnë Autorizim Marketing për Kosovë;
2. Pholcodina në formë të sirupit dhe tabletave të cilat përdoren si antitusik dhe Kodeina fortësia e të cilit është nën 100mg për dozë, përshkruhet në dokumentin DM0107 dhe DM0107P;
3. Barnat që përshkruhen në DM0107 dhe DM0107P, shtojca 5: Lista e barnave që jepën me receta;
4. Barnat të cilat jepën pa receta, shtojca 3: Lista e Barnave të cilat jepën pa recetën e mjekut;
5. Shtojcat e barnave të dhëna në këtë Udhëzim Administrativ pesojnë ndryshime sipas dinamikës së regjistrimit në AKPM;

Neni 8

Ekzekutimi i Recetës

1. Farmacisti ka të drejtë të jap vetëm barin i cili është përshkruar në receta;
2. Farmacisti ka të drejtë, pa konsultim paraprak me mjekun nese bari i përshkruar në receta nga ana e mjekut nuk gjendet ne tregun e barnave të Republikës së Kosovës, të